

ALBANA MEMA

**INSTITUCIONET EKZEKUTIVE NË SHQIPËRI
1920-1924**

**AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
INSTITUTI I HISTORISË**



ALBANA MEMA

**INSTITUCIONET EKZEKUTIVE
NË SHQIPËRI
1920-1924**

Tiranë, 2021

Titulli:

Institucionet ekzekutive në Shqipëri (1920-1924)

Autor:

ALBANA MEMA

Recensenti: **Akademik prof. dr. Beqir META**
Phd. Liridon LIKA

Korrektore gjuhësore: Mimoza KONOMI

Përpunimi teknik & Arti Grafik: Mirela MIHALI

Kopertina: Dorina MUKA

© Autori & Akademia e Studimeve Albanologjike / Instituti i Historisë
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

ISBN 978-9928-289-75-9

Foto në kopertinë: *Qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës duke shkuar drejt Tiranës*
<https://fototeka.arkiva.gov.al/public/file/18353-fotografi-te-ndryshme-te-delegateve-pjesemarrres-ne-kongresin-e-lushnjes>

Botimet albanologjike
Tiranë, 2021

PASQYRA E LËNDËS

<i>Parathënie</i>	9
<i>Hyrje</i>	15
Trashëgimia në sferën e qeverisjes	15

KREU I

KËSHILLI I NALTË OSE REGJENCA..... 29

- Krijimi i Regjencës kolektive (Këshilli i Naltë i Shtetit Shqiptar), arsyet dhe ndikimi i saj në sistemin politik..... 29
- Veprimtaria e institucionit të Kryetarit të Shtetit (Këshillit të Naltë)35
 - *Këshilli i Naltë, autor i grushtit të shtetit të dhjetorit 1921*..... 37
 - *Këshilli i Naltë në kryengritjen antiqeveritare të marsit 1922, dobësimi i mëtejshëm i tij si institucion*..... 63
- Këshilli i Naltë dhe forma e qeverisjes në debatet publike në prag dhe pas zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese 67
- Degradimi përfundimtar i Këshillit të Naltë pas kryengritjes së qershorit 1924..... 77

KREU II

QEVERIA KUSHTETUESE E SULEJMAN DELVINËS (30 JANAR 1920 - 14 NËNTOR 1920)..... 81

- Sfidat dhe veprimtaria e qeverisë..... 83
- Roli i qeverisë së Sulejman Delvinës në Luftën e Vlorës dhe përballja me forcat antiqeveritare dhe separatiste 91
- Përçarja e qeverisë dhe rënia e saj 102

- Vlerësimet për qeverinë e Sulejman Delvinës 111

KREU III

QEVERTË KUSHTETUESE FLUIDE TË KOALICIONIT PARLAMENTAR.....117

- Qeveria e parë e Iljaz Vrionit (19 nëntor 1920 - 1 korrik 1921) 117
 - *Krijimi, përbërja dhe pozita ndërkombëtare e qeverisë..... 117*
 - *Vepërtaria e qeverisë 121*
 - *Përballja e qeverisë Vrioni me Memorandumin për decentralizimin e Shqipërisë së Jugut 131*
 - *Qëndrimi i qeverisë Vrioni ndaj çështjes së minoriteteve..... 136*
- Qeveria e dytë e Iljaz Vrionit (11 korrik - 16 tetor 1921) 142
 - *Krijimi i një qeverie të dobët, një koalicion partiak i imponuar nga rrethanat, profili dhe aktiviteti i qeverisë 142*
 - *Përballja me kryengritjen e Mirditës dhe rënja e qeverisë Vrioni.... 148*
- Qeveria e Pandeli Evangjelit (16 tetor 1921 - 7 dhjetor 1921)..... 153

KREU IV

QEVERTË KUSHTETUESE TË “PARTISË POPULLORE”161

- Qeveria e Xhafer Ypit (24 dhjetor 1921 - 26 dhjetor 1922) 161
 - *Programi dhe masat stabilizuese të qeverisë 161*
 - *Përballja e qeverisë së Xhafer Ypit me kryengritjen e marsit të vitit 1922, pozita dhe veprimet e saj pas kryengritjes..... 168*
 - *Një krisje e re brenda qeverisë Ypi dhe “Partisë Popullore”, vendimi për zhvillimin e zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese 181*
 - *Vlerësimet e përfaqësuesve ndërkombëtarë për vepërtarinë e qeverisë pas shtypjes së kryengritjes 186*
 - *Projektet e qeverisë për marrjen e këshilltarëve të huaj..... 195*
 - *Marrëdhëniet me Lidhjen e Kombeve dhe zgjerimi i njohjeve ndërkombëtare të qeverisë shqiptare..... 197*
 - *Votëbesimet e qeverisë në shtator dhe tetor 1922..... 205*

▫	<i>Shfaqja e krizës së brendshme të qeverisë në vjeshtën e vitit 1922 dhe përballja e saj me presionin italian dhe të fqinjëve të tjerë.....</i>	<i>209</i>
▫	<i>Qeverisja në optikën e Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve.</i>	<i>218</i>
-	Qeveria e Ahmet Zogut (26 dhjetor 1922 - 25 shkurt 1924)	225
▫	<i>Arsyet e formimit të qeverisë dhe programi i saj.....</i>	<i>225</i>
▫	<i>Rezultatet e qeverisë dhe raportet me opozitën</i>	<i>231</i>
▫	<i>Krizat e qeverisë së Ahmet Zogut në verën dhe vjeshtën e vitit 1923</i>	<i>241</i>
▫	<i>Qeveria e Zogut, pas zgjedhjeve të dhjetorit 1923.....</i>	<i>264</i>
-	Qeveria e Shefqet Vërlacit (30 mars - 27 maj 1924).....	271
-	Qeveria e Iljaz Vrionit (27 maj - 10 qershor 1924).....	285
-	Bilanci i qeverisjes kushtetuese në vitet 1920-1924.....	290

KREU V

QEVERITË JOKUSHTETUESE TË DALA NGA KRIZA

E DHJETORIT TË VITIT 1921..... 297

-	Qeveria njëditore e Qazim Koculit (6 dhjetor 1921).....	298
-	Qeveria e Hasan Prishtinës (7-12 dhjetor 1921)	301
-	Qeveria kalimtare e Idhomene Kosturit (12-24 dhjetor 1921)	310

KREU VI

QEVERIA JOKUSHTETUESE E FAN NOLIT

(16 QERSHOR - 24 DHJETOR 1924)..... 313

-	Karakteri, përbërja dhe programi i qeverisë së Nolit.....	313
-	Kriza institucionale e qeverisë së Nolit dhe karakteri i saj	320
-	Reforma agrare dhe dështimi i saj	342
-	Anarkia dhe përçarja kombëtare në Shqipëri gjatë qeverisjes së Nolit dhe tentativat për rrëzimin e saj nga brenda.....	348
-	Dështimi i Nolit dhe reflektimet rreth qeverisjes së tij	360
-	Përpjekjet dhe dështimet në njohjen ndërkombëtare të qeverisë së Nolit.....	370

▫	<i>Analizat e diplomatëve britanikë gjatë qeverisjes së Nolit dhe qëndrimi i qeverisë britanike</i>	370
▫	<i>Qëndrimi i Italisë ndaj qeverisë së Nolit</i>	382
▫	<i>Qëndrimi i SHBA</i>	386
▫	<i>Qëndrimi i Lidhjes së Kombeve</i>	388
▫	<i>Tentativa për vendosjen e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik dhe lidhjet me organizatat prokomuniste</i>	389
▫	<i>Qëndrimi i qeverisë jugosllave</i>	392
▫	<i>Qëndrimi i Greqisë</i>	404
-	Pikëpamjet dhe argumentet mbi izolimin ndërkombëtar të qeverisë së Nolit	406
	Burimet dhe bibliografia	417
	Treguesi i emrave dhe i vendeve	433

PARATHËNIE

Në këtë studim janë trajtuar të gjitha institucionet ekzekutive që vepruan në Shqipërinë e viteve 1920-1924. Qëllimi i tij është analiza e rolit dhe e pozitës së këtyre institucioneve, si në marrëdhëniet e tyre me institucionet politike përfaqësuese dhe me njëri-tjetrin, ashtu edhe në raport me qytetarët dhe shtetin si etnitet politik.

Analiza e krijimit dhe e veprimtarisë së institucioneve në këtë periudhë, është bërë në raport me përputhshmërinë e tyre me dispozitat ligjore të kohës dhe me nevojën për konsolidimin e shtetit, e cila ishte kryefjala e prioriteteve të Shqipërisë së asaj kohe. Ky ka qenë boshti metodologjik nga jemi nisur për shkrimin e kësaj monografie.

Institucionet përfaqësuese që vepruan në Shqipëri në këtë periudhë janë objekt i një studimi të veçantë.

Pushteti ekzekutiv përbëhet nga një tërësi organesh qendrore apo vendore, në krye të të cilave qëndron qeveria si organ kushtetues. Qeveria përbëhet nga kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat, të gjithë organe kushtetuese.

Institucioni i qeverisë në këtë periudhë pati një aktivitet të spikatur, kjo për shkak edhe të numrit të madh të qeverive që vepruan dhe rëndësisë së tyre për funksionimin e të gjitha institucioneve të tjera në vend.

Gjithashtu me rëndësi është edhe institucioni i kryetarit të shtetit, Këshilli të Naltë, i cili në Shqipërinë e asaj kohe kishte një formë specifike shumë interesante por njëherësh edhe mjaft problematike.

Kriter themelor metodologjik i këtij studimi është raporti i ngjarjeve apo figurave historike me detyrat themelore që do të zgjidhte shteti shqiptar në këto vite. Çdo institucion i pushtetit ekzekutiv dhe çdo ngjarje është vlerësuar në raport me kushtetutshmërinë e tyre dhe në funksion të nevojës jetike dhe emergjente të ndërtimit e stabilizimit të shtetit në këtë periudhë.

Në hartimin e studimit është zbatuar kriteri tematiko-kronologjik. Kriteri tematik është përdorur për të përcaktuar kapitujt dhe brenda këtyre të fundit, kriteri kronologjik. Gjatë përgatitjes së studimit, duke pasur parasysh edhe karakterin historik e juridik të tij, jemi konsultuar dhe me studiues të tjerë të periudhës, që kanë kontribuar në këtë fushë.

Në këtë studim, formimi i institucioneve qeverisëse është trajtuar në kuadrin historik të kohës, në lidhje të ngushtë me zhvillimet politike, ekonomike, fetare, shoqërore, arsimore etj. Periudha 1920-1924 ishte një etapë vendimtare në historinë shqiptare, kur u ngritën institucionet kombëtare me karakter të plotë vetëqeverisës të shtetit shqiptar.

Duhet theksuar se analiza e institucioneve ekzekutive në këtë periudhë është bërë duke marrë parasysh elementët konstitucionalë dhe ligjshmërinë e formimit e funksionimit të tyre. Këta elementë do të përcaktonin edhe regjimin e tyre politik [formën e qeverisjes]. Në këtë mënyrë, qeveritë janë grupuar në qeveri kushtetuese dhe qeveri jokushtetuese. Ky klasifikim është bërë në përputhje me legjitimitetin e tyre, i cili përcaktohet në bazë të teorive mbi të drejtën kushtetuese. Në këtë këndvështrim, një qeveri quhet jokushtetuese, kur ajo nuk është e mandatuar nga vullneti i lirë i popullit, i cili është deleguar në asamblatë e ndryshme përfaqësuese të këtij të fundit.

Politikat institucionale të kohës dhe rezultatet e tyre, pra shkalla e suksesit të veprimtarisë dhe performancës së institucioneve qeverisëse, janë vlerësuar në këndvështrimin metodologjik, duke i analizuar ato në raport me forcimin e unitetit të shtetit dhe konsolidimin e tij, me progresin dhe zbatimin e ligjshmërisë në vend. Këtë gjë jemi përpjekur ta bëjmë në të gjitha detajet e analizës që i kemi bërë këtyre institucioneve dhe fenomeneve e dukurive të tjera që lidheshin me to.

Ngritja e institucioneve kombëtare qeverisëse në këtë periudhë, kishte rëndësi të veçantë për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të

këtij shteti. Kjo ishte detyra dhe sfida kryesore e klasës politike të kohës dhe, bashkë me të, e gjithë shoqërisë shqiptare. Prej saj, do të vareshin sukseset apo dështimet në sferat e tjera. Prandaj, edhe proceset apo reformat në vazhdim duheshin konceptuar që të shkronin në harmoni me stabilizimin, fuqizimin dhe modernizimin e shtetit kombëtar dhe të institucioneve të tij.

Nëse klasa politike e vendit, do të kishte pasur në tërësinë e saj, mjaftueshmërisht të qartë këtë koncept, me gjithë vështirësitë e mëdha objektive që ndeshte ajo, rezultatet nuk do të mungonin. Por, siç e kemi analizuar më gjerë në këtë punim, klasa politike shqiptare, më së shumti, dështoi për t'ia nënshtruar veprimtarinë e saj politike këtij objektivit madhor dhe jetik për interesat kombëtare shqiptare.

Shfaqja e egoizmit politik dhe përcaktimi i qëllimit të ardhjes në pushtet, si objektiv parësor mbi atë të interesave themelore të vendit, e në radhë të parë të stabilitetit të tij, ishte një shkak për dështimet e demokracisë parlamentare në këtë periudhë. Por, bashkë me dështimet në sendërtimin e sistemit politik të përparuar të demokracisë parlamentare, si një sistem qeverisës efektiv, u dëmtua rëndë edhe përpjekja për stabilizimin e shtetit dhe konsolidimin e institucioneve politike qeverisëse në Shqipëri.

Si burime themelore për hartimin e këtij studimi kemi shfrytëzuar gjerësisht materialet arkivore. Spikat si një burim i dorës së parë dokumentacioni i gjendur në arkivat kryesore të vendit, në Arkivin Qendror të Shtetit, në të cilin kemi parë fondet që kanë të bëjnë me institucionet kryesore dhe aktorët politikë që vepruan në këtë periudhë, në Arkivin e Institutit të Historisë dhe në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe arkivave të diplomacive të huaja, veçanërisht Arkivave Kombëtare të Britanisë së Madhe (The National Archives) Fondi i Foreign Office (FO) dhe Arkivit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë (Archivio Storico Diplomatico, Ministero degli Affari Esteri (ASD MAE), Roma, të cilat tashmë shfrytëzohen si arkiva digjitale të Institutit të Historisë të Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA). Hulumtimi i këtyre arkivave i ka dhënë një dimension të ri studimit, duke sjellë risi në perceptimin e ngjarjeve, personave dhe sidomos veprimtarisë së

institucioneve të shtetit shqiptar në këtë periudhë, nën optikën e fuqive dhe diplomatëve të huaj.

Një vend qendror në burimet e këtij studimi zënë botimet zyrtare të viteve 1920-1924, ku një rëndësi të veçantë i kemi kushtuar Bisedimeve të Parlamentit në këto vite, Fletoreve Zyrtare dhe Qarkoreve të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Gjithashtu, janë analizuar me hollësi edhe aktet kushtetuese të kësaj periudhe: “Bazat e Kanunores së Këshillit të Naltë” dhe “Zgjanimi i Shtatutit të Shtetit Shqiptar” i vitit 1922. Janë analizuar gjithashtu, programet, kanunoret, rregulloret e partive politike të kësaj periudhe dhe organizatave të tjera jopolitike si dhe programet e qeverive të ndryshme. Është studiuar edhe një bibliografi e gjerë, e autorëve vendas dhe të huaj, dokumente të botuara, kujtime të bashkëkohësve, shtypi i kohës etj.

Gjatë trajtimit të kësaj teme, jemi përpjekur të evidentojmë problemet e diskutuara nga historiografia shqiptare e mëparshme dhe ajo e sotme, duke dhënë, sipas rastit, dhe mendimin tonë rreth objektivitetit apo qëndrimeve të tyre. Po në këtë mënyrë, janë analizuar dhe shfrytëzuar edhe veprat e autorëve të huaj.

Në përfundim, dëshiroj të shpreh falënderime të veçanta dhe mirënjohjen time të thellë për recensentët e punimit. Një falënderim i veçantë shkon për akademik Beqir Metën, i cili me profesionalizmin, mbështetjen e dhënë dhe me këshillat shumë të vlefshme gjatë përgatitjes së studimit, ka kontribuar në të gjitha fazat e hartimit të këtij studimi. Ai gjithmonë ka gjetur kohën për të diskutuar gjatë mbi problematikat jo të pakta të studimit, duke qenë një shtysë dhe ndihmë e vazhdueshme në përfundimin me sukses të tij. Një falënderim shkon edhe për Phd. Liridon Lika, profesor në Universitetin e Liezhit (Belgjikë) dhe atë të Mastrihtit (Holandë), sugjerimet e të cilit ishin me vlerë dhe ndikuan pozitivisht në këtë libër.

Gjithashtu, nuk mund të lë pa falënderuar profesorët dhe kolegët e mi të Institutit të Historisë, për dashamirësinë e treguar në dhënien e mendimeve dhe këshillave në çdo rast si dhe për mbështetjen dhe inkurajimin e vazhdueshëm për të ecur përpara në realizimin e këtij studimi. Një pjesë e tyre e lexuan me kujdes punimin dhe dhanë sugjerime me vlerë. Në mënyrë të veçantë, drejtuesen e Departamentit të Historisë së Pavarësisë dhe Konsolidimit të Shtetit Shqiptar, prof.

asoc. dr. Ledia Dushku, e cila me profesionalizmin dhe skrupulozitetin e saj ka një kontribut të veçantë për përmirësimin e studimit. Po ashtu i detyrohem thellësisht Mirelës, Mimosës, Melit, Lindës dhe Ornelës, për ndihmën e dhënë që ky studim të merrte formë të plotë.

Së fundi, dua të shpreh veçanërisht mirënjohjen për familjen time që më ka mbështetur, ndihmuar e mirëkuptuar, duke qenë një burim i fuqishëm inkurajimi dhe frymëzimi në punën time shkencore.

Autorja